2861/6
27.10.2026

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A.

Nr. 5708/2, Prot. Tiranë, më 27/10/2026

Lënda: Komentet e Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. mbi "Projekt-rregullore "Për kërkesat minimale në përmbajtjen e faturave të energjisë elektrike dhe informacionin e faturimit" miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 273, datë 25.09.2026".

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
KRYETAR
Z. PETRIT AHMETI
Adresa: Irfan Tomini, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A. (tani e tutje FSHU), me anë kësaj shkrese, paraqet komentet e tij mbi "Projekt-rregullore "Për kërkesat minimale në përmbajtjen e faturave të energjisë elektrike dhe informacionin e faturimit" miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 273, datë 25.09.2026", dërguar nëpërmjet shkresës së Entit Rregullator të Energjisë me Nr. 9439 datë 12.10.2026. Në këtë kuadër propozojmë ndryshimet që i konsiderojmë të nevojshme në rregulloren që do të miratojë Enti Rregullator i Energjisë, si vijon:

- **Në Nenin 3 "*Përkufizime*", gërma "c", *"Vetëleximi i matësit"*, të shtohen fjalitë si më poshtë:**

Të dhënat e vetëleximit i nënshtrohen verifikimit dhe trajtimit sipas rregullave në fuqi për matjen, faturimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe furnizuesit. Furnizuesi ka detyrimin për vlerësimin e vetëleximit dhe të drejtën për të lëshuar faturën sistemuese, nëse ka mospërputhje midis energjisë së konsumuar dhe asaj të vetëlexuar nga klienti.

Sugjerimi ynë për riformulimin e klauzoles ka qëllim sqarues dhe mbështetet në eksperiencën e përballjes me tendenca abuzive për mos pagimin e detyrimeve. Ky riformulim i propozuar nga shoqëria FSHU SH.A. është në përputhje edhe me parashikimet / rregullimin e të njëjtit proces në

nenin 14 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike, dokument i publikuar për konsultim nga ERE, në të cilin citohet:

14.1 OSSH-ja kryen leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Shpërndarjes dhe të legjislacionit në fuqi për metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh.

14.2 *Për furnizimin me energji elektrike, pa cënuar përgjegjësinë e OSSH-së për kryerjen e leximit të matësit, Klienti mund të kryejë vetëleximin e matësit për një periudhë 30-ditore dhe ia komunikon furnizuesit ditën e fundit të muajit. Furnizuesi e njofton klientin nëse i ka pranuar të dhënat e vetëleximit të ofruara prej tij në një nga mënyrat e zgjedhura sipas Aneksit 3 ose nëse nuk i ka pranuar ato, në rastet kur rezultojnë qartazi të pasakta ose në mospërputhje me leximin e fundit real në dispozicion. Vetëleximi trajtohet si lexim real për qëllime faturimi, nëse vërtetohet nga OSSH-ja brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 muaj. Në fund të periudhës 12-mujore, Furnizuesi ka të drejtë të lëshojën faturën sistemuese, nëse ka mospërputhje.*

Në këtë nen, gjithashtu propozojmë të shtohet një përkufizim lidhur me Skemën e kompensimit bazuar në faturimin neto, si vijon:

"Skema e kompensimit bazuar ne faturimi neto" – nënkupton mekanizmin e faturimit neto, nëpërmjet të cilit energjia elektrike e vetëprodhuar nga klienti dhe injektuar në rrjetin shpërndarës do të blihet nga furnizuesi, duke kompensuar vlerën e energjisë së konsumuar nga klienti.

- **Në Nenin 7, gërma "d", pas fjalisë së parë të shtohet fjalia me përmbatjtjen si më poshtë:**

Në rastet kur klienti është pajisur me matës inteligjent, i cili transmeton automatikisht të dhënat e konsumit në intervale të përcaktuara, në platformën e menaxhuar nga Operatori i Sistemit, fatura plotësohet mbi bazën e të dhënave të regjistruara dhe të administruara në këtë platformë, pa të dhënat e leximit pararendës dhe leximin aktual të aparatit matës.

- **Në Nenin 9 "Afati dhe mënyra e pagesës", pas gërmës "e" të shtohet gërma "f" me përmbajtjen:**

f) data në të cilën duhet të bëhet pagesa.

- **Neni 14, pika 2 të riformulohet si më poshtë:**

2. Pas kalimit të afatit të përcaktuar ne pikën 1 më sipër, faturimi për Klientin në ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero.

Kjo situatë është adresuar në nenin 8.3 të Kushteve të propozuara nga FSHU, ku përcaktohet që: "*Pas kalimit të afatit të përcaktuar ne pikën 2 më sipër, faturimi për Klientin në ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero*".

Ky formulim konsiderohet më i drejtë, pasi, duke i alokuar përgjegjësi Furnizuesit për një mos veprim të OSSH, keq-drejtojmë palët në kuptimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tyre.

- Duke qenë se në këtë rregullore nuk rezultojnë të parashikuara në mënyrë të posacme kërkesat lidhur me faturimin e konsumatorëve aktiv apo konsumatorëve vetëprodhues, si dhe informacion specifik që duhet të përmbajë fatura e energjisë elektrike për këtë kategori konsumatorësh, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 368, datë 20.05.2026, propozojmë që:

Në Nenin 8, pas gërmës 'd' të shtohet një pikë me përmbajtjen:

- *vlerën e kompensimit nga energjia e vetëprodhuar.*

Pas Nenit 11 të shtohet një nen i posaçëm për të dhënat e vetëprodhuesve, me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 12
Të dhënat për vetëprodhimin

Në faturë duhet të pasqyrohet informacioni për skemën e kompensimit bazuar në faturimin neto, duke evidentuar si zëra të veçantë sasinë dhe vlerën e energjisë elektrike të injektuar në rrjetin shpërndarës nga klientët-vetëprodhues dhe kreditet për efekt të kompensimit:

a) *Sasia mujore e energjisë së injektuar në rrjetin shpërndarës nga Klienti-vetëprodhues, leximin pararendës dhe leximin aktual i matësit. Vlera mujore e kreditit;*
b) *Sasia vjetore e energjisë së injektuar injektuar në rrjetin shpërndarës nga Klienti-vetëprodhues dhe vlera e saj;*
c) *Kreditet e mbartura nga periudha paraardhëse dhe krediti që mbartet në periudhën pasardhëse;*
d) *Kreditet monetare që zerohen në fund të vitit kalendarik.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, FSHU SH.A. mbetet e gatshme për çdo sqarim shtesë të nevojshëm.

Me konsideratë,

ADMINISTRATORI I FSHU SH.A.
Algert LUZI